



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2021

V E N D I M

Nr. 131, datë 14/07/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.32, datë 02.03.2021, e një grupi personash nga qyteti i Pogradecit, përkatësisht z. A.V., znj. G. E., znj. F.Rr., znj.M.R.. dhe znj. E.K.të cilët pretendojnë diskriminim për shkak të “racës”¹ (egjiptiane) nga ana e Bashkisë Pogradec.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se qytetarët e sipërcituar i përkasin komunitetit egjiptian të qytetit të Pogradecit dhe jetojnë në banesat e tyre prej 50 vitesh. Ata pretendojnë se këto banesa janë ndërtuar prej pothuaj një shekulli dhe janë tepër të amortizuara. Ankuesit sqarojnë se kanë depozituar pranë Bashkisë Pogradec disa kërkesa, nëpërmjet së cilave kanë kërkuar rindërtimin e banesave të tyre, por nga ana e këtij institucioni nuk ka patur asnjë reagim.

Qytetarët pretendojnë se në vitin 2017, Bashkia Pogradec i ka vënë në dijeni se banesat e tyre janë në pronësi të shtetit dhe se familjet e tyre do të shpronësohen, pasi në vendndodhjen e banesave të tyre do të ndërtohet një parkim. Banorët sqarojnë se shpronësimi publik do të kryhet kundrejt një vlere të vogël, në referencë të çmimit të vendosur nga shteti, me të cilën ata nuk mund të blejnë një apartament tjetër, për të strehuar familjet e tyre.

Grupi i ankuesve e ka informuar Komisionerin, se në një takim që ata kanë patur me Nënkryetarin e Bashkisë Pogradec, z. P. Z., nga ana e tij u është premtuar se familjet e tyre do të trajtohen nëpërmjet njërës prej programeve të strehimit, që ky institucion zbaton për familjet

¹ Mbështetur në përkufizimin e ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI(2003)8, adopted 13 December 2002, par 1(b) “diskriminimin racor” përfshin “racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”.

e pastreha, ndërkohë që ata theksojnë faktin se Bashkia Pogradec ende nuk ka vepruar. Ankuesit shprehen se pas tërmetit të vitit të kaluar banesat e tyre janë dëmtuar dhe janë bërë të pabanueshme. Në këto kushte, ata pretendojnë se po diskriminohen nga Bashkia Pogradec, pasi ata i përkasin komunitetit egjiptian.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të racës, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me **racën**, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr.32, datë 02.03.2021, e një grupi personash nga qyteti i Pogradecit, përkatësisht z. A. V., znj. G. E., znj. F. R., znj. M. R.³ dhe znj. E. K., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Pogradec me shkresën nr. 404/1, datë 10.03.2020, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesve;
 2. Korrespondenca zyrtare e Bashkisë Pogradec me ankuesit, lidhur me rindërtimin e banesave të tyre;
 3. Korrespondenca zyrtare e Bashkisë Pogradec me ankuesit, lidhur me çështjen e shpronësimit publik të banesave të tyre;
 4. Informacion mbi periudhën kohore, kur do të kryhet procesi i shpronësimit publik;
 5. Informacion mbi zgjidhjen e menduar nga Bashkia Pogradec, lidhur me çështjen e strehimit të familjeve të ankuesve, pas kryerjes së shpronësimit publik të banesave të tyre. Të jepet informacion i hollësishëm mbi hapat konkretë, që janë planifikuar dhe ndërmarrë, nga ky institucion;
 6. Informacion mbi vlerën totale të shpronësimit për secilën familje, si dhe aktet përkatëse;
 7. Praktika e shpronësimit publik për secilën familje;
- Në përgjigje të shkresës nr. 404/1, datë 10.03.2020, së KMD-së, Bashkia Pogradec, dërgoi shkresën nr. 1199/1, datë 24.03.2021, nëpërmjet së cilës informon se nëpërmjet shkresës nr. 2458, datë 24.04.2018, Bashkia Pogradec ka bërë kërkesën për shpronësim për interes publik

³ Në vijim të korrespondencës me Bashkinë Pogradec, KMD u bë me dije se znj. Maria Rushit nuk legjitimohej për të depozituar ankesë pranë Komisionerit pasi nuk rezultoi pronare e apartamentit, që është në procedurë shpronësimi;

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

të pasurive në pronësi të A. V., G. E., F. Rr. dhe E. K., përkatësisht me nr. 1/8 + 2-1, Nr. 1/81 +4-1, 1/81 +1-1, 1/81 +6-1, që preken nga zbatimi i projektit të miratuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 604, datë 20.12.2017 për objektin “Sistemim rrugësh, blloku te stadiumi”.

Llogaritja e vlerës së shpronësimit të këtyre pasurive është kryer bazuar në VKM nr. 138, datë 23.03.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, ku vlerësimi për objektet e banimit përcaktohet si mesatare e shitblerjeve, përcaktuar nga ZRPP-ja sipas procedurës për rastin e trullit.

Me shkresën nr. 1966, datë 30.12.2019, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë dërguar njoftimet për shpronësim publik, ku është pasqyruar vlera totale e shpronësimit për secilin dhe mënyra e llogaritjes së saj. Kërkesa nr. 10 966/1, datë 30.12.2019, për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga zbatimi i projektit “Sistemim rrugësh, blloku te Stadiumi” është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 13.01.2020.

Me shkresën nr. 5643/3, datë 12.11.2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njofton Bashkinë Pogradec se: “Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka të pamundur garantimin e mbulimit të fondeve nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë për shpronësimin e këtij projekti” dhe kërkon të shihet mundësia e përballimit të këtij fondi nga buxheti i Bashkisë Pogradec për vitin 2021.”

Bashkia Pogradec sqaron se nuk ka fonde të planifikuara për përballimin e efektit financiar të procedurës së shpronësimeve të pasurive, që preken nga zbatimi i projektit “sistemim rrugësh, blloku te Stadiumi”.

Ky institucion sqaron gjithashtu se meqënëse vlera e shpronësimit për secilin është e vogël për të blerë banesë, Bashkia Pogradec e ka prioritet trajtimin e këtyre familjeve në programet e strehimit që zbaton për familjet e pastreha.

Bashkëlidhur shkresës nr. 1199/1, datë 24.03.2021, Bashkia Pogradec ka dërguar aktet e poshtëcituar:

1. Lejen e ndërtimit;
2. Kopje e planimetrisë sipas së cilës janë llogaritur sipërfaqet e pronave që preken nga zbatimi i këtij projekti;
3. Kërkesa për shpronësim;
4. Lista paraprake e shpronësimeve;
5. Njoftimet për shpronësim.

- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 404/3, datë 24.05.2021, të KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet **në datën 01.06.2021, ora 10:00**, pranë Zyrës së KMD-së.

Nëpërmjet shkresës së sipërcituar, Komisioneri kërkoi nga përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec të depozitonin në seancë dëgjimore, informacionin vijues:

1. Informacion mbi fazën, në të cilën ndodhet procesi i shpronësimit të ankuesve, si rrjedhim i zbatimit të *projektit: “Sistemit rrugësh, blloku te Stadiumi”, Pogradec*”;
2. Informacion nëse të gjithë familjet e shpronësuara në kuadër të këtij projekti i përkasin komunitetit egjiptian.
3. Informacion mbi projektet e strehimit, që aktualisht po zbaton Bashkia Pogradec dhe mënyra se si është planifikuar sistemimi i familjeve ankuese;
4. Kopje e shkresës nr. 5643/3, datë 12.11.2020, së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

Njëkohësisht, KMD kërkoi edhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të depozitonin në seancë dëgjimore, informacionin vijues:

1. Informacion mbi procesin e shpronësimit të ankuesve në qytetin e Pogradecit, i lidhur ky me Kërkesën nr. 10966/1, datë 30.12.2019, *“Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit: “Sistemit rrugësh, blloku te Stadiumi”, Pogradec”*;
2. Informacion mbi arsyet e mos kryerjes së kompensimit financiar të ankuesve, brenda vitit 2021 dhe kur është planifikuar të kryhet ky kompensim;
3. Kopje e plotë e praktikës së shpronësimit për interes publik, në zbatim të projektit: *“Sistemit rrugësh, blloku te Stadiumi”, Pogradec*”;

Në seancë dëgjimore nuk u paraqit asnjë nga palët.

- Në vijim, Komisioneri iu drejtua me shkresën nr. 404/4, datë 03.06.2021, Bashkisë Pogradec dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke i kërkuar edhe një herë informacionin e sipërcituar.
- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Bashkia Pogradec dërgoi shkresën nr. 404/5, datë 11.06.2021, nëpërmjet së cilës informon se pas kërkesës për shpronësim për interes publik të pasurive, që preken nga zbatimi i projektit *“Sistemit rrugësh, blloku tek Stadiumi”* me shkresën nr.2458, datë 24.04.2018, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 1966, datë 30.12.2019, dërgoi njoftimet për shpronësim publik, ku është pasqyruar vlera totale e shpronësimit për secilin edhe mënyra e llogaritjes së saj.

Kërkesa e sipërcituar u botua në Fletoren Zyrtare, të datës 13.01.2020. Në vijim, me shkresën nr 5643/3, datë 12.11.2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njofton Bashkinë Pogradec se: *“Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka të pamundur garantimin e mbulimit*

të fondeve nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë për shpronësimin e këtij projekti” dhe kërkon të shihet mundësia e përballimit të këtij fondi nga buxheti i Bashkisë Pogradec për vitin 2021. Me shkresën nr. 1811 prot., datë 20.04.2021, Bashkia Pogradec informon Drejtorinë e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë MEF, se në buxhetin e vitit 2021, nuk janë planifikuar fondet për shpronësimet, pasi Bashkia ka një borxh rreth 350.000.000 lekë, gjë që e bën të pamundur planifikimin e shumë nevojave si për shpronësimet, ashtu edhe për shpenzime korrente. Ky institucion kërkon ndihmën dhe mirëkuptimin e MEF-së për çeljen e këtij fondi nga Ministria e Financave.

Lidhur me informacionin, nëse të gjitha familjet e shpronësuara, në kuadër të këtij projekti, i përkasin komunitetit egjiptian, Bashkia Pogradec sqaron se gjatë procedurës së shpronësimit nuk janë evidentuar, se cilit komunitet i përkasin familjet e shpronësuara.

Njëkohësisht, ky institucion thekson faktin se po punon mbi zbatimin e projektit “Përmirësim/rikonstrukcion i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Pogradec”. Në këtë projekt nuk janë trajtuar familjet që janë në listën e shpronësimeve të pasurive pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Sistemim rrugësh, blloku tek stadiumi”.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk i ktheu përgjigje shkresës së Komisionerit.

A. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesve.

Pretendimi i katër ankuesve, që i përkasin komunitetit egjiptian të qytetit të Pogradecit, konsiston së pari në mos rindërtimin e banesve të tyre, të cilat janë të ndërtuara prej më shumë se 1 shekulli dhe kanë nevojë për rikonstrukcion. Në bazë të dokumentacionit të depozituar në cilësi prove, si dhe në bazë të korrespondencës zyrtare me Bashkinë Pogradec rezulton se këto banesa ishin planifikuar për t’u përfshirë në shpronësim për interes publik që prej vitit 2017. Në këto kushte, Bashkia Pogradec nuk kishte planifikuar kryerjen e rikonstrukcionin të këtyre banesave, edhe pse ato ishin të dëmtuara dhe kishin nevojë për ndërhyrje riparuese.

Pretendimi vijues i ankuesve konsiston në çështjen e shpronësimit për interes publik të pasurive të tyre të paluajtëshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi”, Pogradec. Ata nuk janë dakord me shpronësimin publik, duke vënë në dukje faktin se vlera totale paraprake e shpronësimit është e pamjaftueshme për të blerë një apartament tjetër. Ankuesit kërkojnë ndërhyrjen e KMD pranë Bashkisë Pogradec me qëllim sistemimin e tyre, në momentin që shpronësimi për interes publik do të zbatohet.

Për sa më sipër, shpronësimi i pasurisë së paluajtëshme ose të luajtshme, pronë private për interesa publike është një proces që rregullohet nëpërmjet dispozitave të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, të ndryshuar.

Në nenin 5, pika 1, të këtij ligji parashikohet se: “Kur realizimi ose mbrojtja e interesave publike nuk mund të arrihet pa ushtruar të drejtat e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme ose të luajtshme pronë private, Këshilli i Ministrave, mbi kërkesën e subjektit kërkues në favor të të cilit bëhet shpronësimi, me propozim të ministrit kompetent sipas këtij ligji, vendos shpronësimin e këtyre pasurive.” Objekte të shpronësimit⁵ janë pasuritë e paluajtshme në formën e tokës, të ndërtimeve të çdo lloji me karakter të përhershëm. Sipas nenit 9, të ligjit të sipërcituar, shpronësimi mund të bëhet në favor të shtetit dhe të personave juridikë publikë ose privatë, vendas ose të huaj, për realizimin nga ana e tyre të një projekti, investimi apo objekti që, në çdo rast në përputhje me këtë ligj, paraqet interes publik.

Referuar dokumentacionit të depozituar në cilësi prove rezulton se në bazë të shkresës nr. 2458 prot., datë 24.04.2018, të Bashkisë Pogradec “Kërkesë për shpronësim publik”⁶ drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është kërkuar shpronësimi për interes publik të disa pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi”, Pogradec. Bashkëlidhur kërkesës është dërguar edhe dokumentacioni përkatës i përcaktuar nga ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar, i cili konsiston në aktet e mëposhtme:

- Tabela e Listës së shpronësimeve për objektin “Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi”, Pogradec;
- Harta e shpronësimeve sipas projektit;
- Fragmente të hartës së shpronësimeve;
- Statusi juridik nga Z.V.R.P.P.;
- Projekti i miratuar dhe leja e ndërtimit;
- Kopje e shkresës për çmimin mesatar për pasurinë Apartament me nr. 2135 prot., datë 17.04.2018, protokolluar pranë Bashkisë Pogradec me nr. 2135/1, datë 17.04.2018;

Pasuritë e paluajtëshme, pronë private, për të cilat është kërkuar shpronësim për interes publik janë si më poshtë vijnë:

1. Pasuria Nr. 1/388, truall, Sipërfaqe në total – 406.76 m², me sipërfaqe shpronësimi - 23.39 m², ZK. 8581, me pronar z. Th. M. N., L. M. N., T. K. I. dhe Dh. K. S.;

⁵ Referuar nenit 7 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, të ndryshuar.

⁶ Kërkesa për shpronësim e Bashkisë Pogradec është botuar në Fletorën Zyrtare të datës 13.01.2020;

2. Pasuria Nr. 1/80, truall, Sipërfaqe në total – 1261 m², me sipërfaqe shpronësimi -8637 m², ZK. 8581, me pronar Ll. Dh. B., M. Dh. B. dhe B. Gj. B.;
3. Pasuria nr. 1/443, truall, me sipërfaqe në total – 508 m², me sipërfaqe shpronësimi – 322.27 m², Zk. 8581, pronar Vllazëria G.;
4. Pasuria Nr. 1/125, truall, me sipërfaqe në total – 110 m², me sipërfaqe shpronësimi – 110 m², ZK. 8581, me pronar J. Ll. V. dhe D. Ll. V.;
5. Pasuria Nr. 2/134, truall, me sipërfaqe në total - 22.5 m², me sipërfaqe shpronësimi – 22.5 m², ZK. 8581, me pronar A. A. D., M. A. D., S. D., N. A. D., G. D. dhe L. D.;
6. Pasuria Nr. 2/132, truall, me sipërfaqe në total – 114 m², me sipërfaqe shpronësimi – 114 m², ZK. 8581, me pronar N. A. D.;
7. Pasuria nr. 2/133, truall, me sipërfaqe në total – 114 m², me sipërfaqe shpronësimi – 114 m², ZK. 8581, me pronar M. A. D.;
8. Pasuria Nr. 2/333, truall, me sipërfaqe në total - 224 m², me sipërfaqe shpronësimi – 224 m², ZK. 8581, me pronar G. N. D., F. D. dhe M. D.;
9. Pasuria Nr. 6/388, truall, me sipërfaqe në total - 993 m², me sipërfaqe shpronësimi – 63.96 m², ZK. 8581, me pronar Dh. V. M., G. M., L. M. dhe B. M.;
10. Pasuria Nr. 6/450, truall, me sipërfaqe në total - 3940 m², me sipërfaqe shpronësimi – 35.93 m², ZK. 8581, me pronar H. S. M. (B);
- 10.1. Pasuria Nr. 6/450, truall, me sipërfaqe në total - 3940 m², me sipërfaqe shpronësimi – 55.46 m², ZK. 8581, me pronar H. S. M. (B).
11. Pasuria Nr. 2/135, truall, me sipërfaqe në total - 120 m², me sipërfaqe shpronësimi – 13.67 m², ZK. 8581, me pronar S. K. A.;
- 12. Pasuria Nr. 1/81 + 2-1 Apartament, me sipërfaqe në total – 48.2 m², me sipërfaqe shpronësimi – 48.2 m², ZK. 8581, me pronar A. V. dhe Z. Q. V.**
- 13. Pasuria Nr. 1/81 + 3-1 Apartament, me sipërfaqe në total – 40 m², me sipërfaqe shpronësimi – 40 m², ZK. 8581, me pronar P. D. R., L. J. R. dhe G. P. R.;**
- 14. Pasuria Nr. 1/81 + 4-1 Apartament, me sipërfaqe në total – 25 m², me sipërfaqe shpronësimi – 25 m², ZK. 8581, me pronar G. Xh. E. dhe N. Xh. E.;**
- 15. Pasuria Nr. 1/81 + 6-1 Apartament, me sipërfaqe në total – 27.3 m², me sipërfaqe shpronësimi – 27.3 m², ZK. 8581, me pronar E. Sh. K.;**
- 16. Pasuria Nr. 1/81 + 1-1 Apartament, me sipërfaqe në total – 25.5 m², me sipërfaqe shpronësimi – 25.5 m², ZK. 8581, me pronar F. I. R.;**
- 17. Pasuria Nr. 1/81 + 1-1 Apartament, me sipërfaqe në total – 67.7 m², me sipërfaqe shpronësimi – 67.7 m², ZK. 8581, me pronar L. N. B. dhe L. F. B.;**

Për sa më sipër, rezulton se në këtë shpronësim janë përfshirë 18 (tetëmbëdhjetë) pasuri, ndër të cilat pjesa më e madhe është troje dhe 6 (gjashtë) prej tyre janë apartamente. Referuar

pikave 12, 14, 15 dhe 16, të listës së sipërcituar, pasuritë e ankuesve përbëhen nga apartamente.

- **Lidhur me mospranimin e ankesës së znj. M. R.**

Në listën e sipërcituar nuk rezulton që ankuesja M. R., të jetë pronare apo bashkëpronare për ndonjërin prej pasurive. Kjo e fundit ka depozituar në cilësi prove aktin “Çertifikatë për Vërtetim Pasurie” për pasurinë 1/81 + 3-1 e cila rezulton në pronësi të P. D. R., L.J. R. dhe G. P. R., por jo në emër të saj.

Në këtë kontekst, në bazë të nenit 44, pika 2, nenin 65, gërma b), pikën 1, të nenit 128 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe mbështetur në nenin 33, pika 4, gërma ç), të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur:ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.”, Komisioneri gjykon se znj. Marie Rushit, e cila nuk është pronare legjitime e pasurisë në fjalë, nuk legjitimohet për paraqitur ankesë pranë KMD-së dhe ankesa e saj nuk pranohet, pasi është haptazi e pabazuar.

- **Ndërkohë që, Komisioneri vazhdoi procedurën e shqyrtimit për ankesat e 4 (katër) ankuesve të tjerë.**

Gjatë analizimit të akteve të depozituara në cilësi prove, Komisioneri konstatoi se kërkesa për shpronësim e Bashkisë Pogradec është bërë në mbështetje të bazës ligjore, të mëposhtëme:

1. Neni 8, gërma ç), të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për këto shkaqe: ç) Për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut.;
2. Neni 10, pika 1, të ligjit të sipërcituar, ku parashikohet se: “Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë ne ministrinë kompetente sipas ligjit, kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: a) Aktet që vërtetojnë cilësinë dhe regjistrimin e tij si person juridik. b) Projektet e nevojshme dhe të miratuara sipas ligjit, si dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik, lidhur me realizimin e këtyre projekteve. c) Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit. ç) Vlerësimi paraprak i objekteve të shpronësimit dhe i masës së shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat. d) Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet. dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse. e) Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të

cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës. ë) Dokumentet që vërtetojnë shkaku të shpronësimit, sipas nenit 8 të këtij ligji.”;

3. Neni 11, të të njëjtit ligj, ku parashikohet shprehimisht: “1. Kërkesat për shpronësim paraqiten në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, ndërsa propozimi në Këshillin e Ministrave për miratimin e kërkesës për shpronësim, bëhet nga ministri përkatës. 2. Me paraqitjen e kërkesës për shpronësim për interes publik, ministri kompetent urdhëron ngritjen e komisionit të posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit. 3. Anëtarët e komisioneve duhet të jenë nëpunës ose ekspertë të pavarur, me përvojë dhe kualifikim të posaçëm në fushën juridike, ekonomike dhe inxhinierike, të cilët, në çdo rast, nuk duhet të kenë lidhje fisnore apo krushqie me të shpronësuarit, ose lidhje interesash të çdo lloji me palët e interesuara për shpronësimin.”

Në vijim të aktit të sipërcituar, mbështetur në nenin 14⁷, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar, si dhe pikës 3, të Vendimi nr. 126, datë 23.03.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen dhe procedurat e punës së Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i është drejtuar të gjithë ankuesve me shkresat “Njoftim për shpronësim publik”, nëpërmjet së cilave subjektet që do të shpronësohen, njoftohen mbi shpronësimin e pasurisë përkatëse, që rezulton në pronësi të tyre, sipërfaqen e shpronësimit, vlerën totale të shpronësimit për secilin dhe mënyrën e llogaritjes së saj.

Në shkresat e njoftimit citohet gjithashtu: “Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar, keni të drejtë që brenda 15 ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletore Zyrtare, të paraqitni pretendimet tuaja nëse keni, pranë Bashkisë Pogradec, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Në njoftimet përkatëse drejtuar të gjithë pronarëve të trojeve që do t’i nënshtroheshin shpronësimit për interes publik është sqaruar fakti se përlllogaritja e vlerës së sipërfaqes përkatëse që do të shpronësohej është kryer në bazë të VKM nr. 138, datë 23.03.2000, “Për

⁷ Neni 14, i ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar parashikohet : 1. Ministria kompetente, brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit, fillon përbushjen e procedurave të njoftimit të drejtpërdrejtë të secilit pronar a bashkëpronar të pasurive pronë private që kërkohet të shpronësohen ose zhvlerësohen, si dhe personave të tretë lidhur me kompensimin e tyre. Së bashku me procedurat e njoftimit, ministri kompetent realizon edhe ato të publikimit të kërkesës për shpronësim për interes publik. 2. Rregullat e hollësishme për mënyrën e njoftimit, përmbajtjen e tij dhe procedurat përkatëse caktohen me akt normativ të Këshillit të Ministrave.”

kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të perosnave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, ku vlerësimi për objektet e banimit përcaktohet si mesatare e shitblerjeve, përcaktuar nga ZRPP-ja sipas procedurës për rastin e truallit.

- Referuar shkresës nr. 10966 prot., datë 30.12.2019, “Njoftim për shpronësim publik” të Ministrisë së Infrastrukturës drejtuar z. A. V. dhe znj. Z. Q. V. rezulton se:

“Sipërfaqe e ndërtesës që shpronësohet është $48.2 \times 45,216 \text{ lekë m}^2 = 2,179,411.20 \text{ lekë}$ ”

*Vlera totale paraprake e shpronësimit është = **2,179,411.20 lekë**”*

- Referuar shkresës nr. 10966 prot., datë 30.12.2019, “Njoftim për shpronësim publik” të Ministrisë së Infrastrukturës drejtuar znj. G. Xh. E. dhe z. N. Xh. E.” dhe Bashkisë Pogradec, rezulton se:

“Sipërfaqe e ndërtesës që shpronësohet është $25 \text{ m}^2 \times 45,216 \text{ lekë m}^2 = 1,130,400 \text{ lekë}$ ”

*Vlera totale paraprake e shpronësimit është = **1,130,400 lekë**”*

- Referuar shkresës nr. 10966 prot., datë 30.12.2019, “Njoftim për shpronësim publik” të Ministrisë së Infrastrukturës drejtuar znj. F. I. R. dhe Bashkisë Pogradec, rezulton se:

“Sipërfaqe e ndërtesës që shpronësohet është $25.5 \text{ m}^2 \times 45,216 \text{ lekë m}^2 = 1,153,008 \text{ lekë}$ ”

*Vlera totale paraprake e shpronësimit është = **1,153,008 lekë**”*

- Referuar shkresës nr. 10966 prot., datë 30.12.2019, “Njoftim për shpronësim publik” të Ministrisë së Infrastrukturës drejtuar znj. E. Sh. K. dhe Bashkisë Pogradec, rezulton se:

“Sipërfaqe e ndërtesës që shpronësohet është $27.3 \text{ m}^2 \times 45,216 \text{ lekë m}^2 = 1,234,396,80 \text{ lekë}$ ”

*Vlera totale paraprake e shpronësimit është = **1,234,396,80 lekë**”*

Në nenin 14, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar, parashikohet: “1. Njëkohësisht me njoftimin e kërkesës për shpronësim për interes publik, sipas pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, për të krijuar mundësitë për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të tretë ndaj ose për shkak të pasurive pronë private që kërkohet të shpronësohen, ministria kompetente bën publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, në një gazetë me shpërndarje në të gjithë vendin dhe në një gazetë vendore për një periudhë njëjavore. 2. Personat e tretë, jo më vonë se 15 ditë nga data e plotësimit të afateve të publikimit sipas këtij neni, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente. 3. Në rastin kur pretendimet e personave të tretë mbi pronësinë, si dhe për kushtet e ofruara të shpronësimit, vërtetohen se janë të mbështetura në ligj, ministria kompetente procedon me shpronësimin, duke respektuar edhe këto të drejta.”

Për sa më sipër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka botuar në fletoren zyrtare nr. 188, datë 13.01.2020, Kërkesën nr. 10966/1, datë 30.12.2019, “Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit: “Sistemim rrugësh, blloku te Stadiumi”, Pogradec”. Në këtë kërkesë citohet: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit: “Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi”, Pogradec. Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Pogradec. Me anë të këtij publikimi, kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar sipas tabelës paraprake bashkëlidhur. Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, keni të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, të paraqitni pretendimet tuaja nëse keni, pranë Bashkisë Pogradec, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Vlera totale paraprake e shpronësimit është 23,004,584,25 (njëzet e tre milion e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzet e pesë) lekë.

Për sa më sipër, rezulton se për çdo mos dakordësi të pronarëve, lidhur me çështje që lidhen me shpronësimin e tyre, ata duhet t’i drejtoheshin Bashkisë Pogradec dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletore Zyrtare. Afati i ankimit ka qenë deri në datën 20.01.2020.

Pala ankuese ka depozituar në cilësi prove shkresën nr. 45, datë 05.11.2020, e znj. M. V., znj. G. E., znj. F. R. dhe znj. E. Sh. drejtuar Bashkisë Pogradec, ku kërkohet e gjithë praktika e shpronësimit dhe dokumentacioni përkatës. Komisioneri konstatoi se kjo shkresë nuk përbën ankesë lidhur me çështjen e shpronësimit të tyre, si dhe është dërguar jashtë afatit të përcaktuar më sipër. Bashkia Pogradec u ka kthyer përgjigje zyrtare kërkuesve, duke u rikujtuar shkresën “Njoftim për Shpronësim” të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përlllogaritjen e kryer lidhur me vlerën përkatëse.

Referuar neneve 20-21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë për interes publik”, i ndryshuar rezulton se me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, ministri kompetent i paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe në vijim Këshilli i Ministrave vendos mbi shpronësimin në rastet kur propozimi për shpronësim gjendet i bazuar në ligj dhe në fakt.

Referuar informacionit të përcjellë nga Bashkia Pogradec rezulton se shpronësimi në fjalë është ende përgjatë procedurave paraprake dhe ende nuk është finalizuar me akt nënligjor.

Gjatë hetimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se pjesë e shpronësimit për interes publik, në kuadër të zbatimit të projektit “*Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi*”, Pogradec janë 18 (tetëmbëdhjetë) familje, ndër të cilat edhe edhe 4 (katër) familjet, që ndodhen në cilësinë e palës ankuese. Shqetësimi i familjeve ankuese qëndron në faktin se vlera e shpronësimit nuk është e mjaftueshme për të blerë një apartament të ri. Këto familje, aktualisht jetojnë ende në banesat e tyre, pasi procedurat e shpronësimit janë ende në proces dhe ende nuk është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se Bashkia Pogradec duhet të planifikojnë dhe ndërmarrë hapat e nevojshme për sistemimin e këtyre familjeve në banesa, nëpërmjet projekteve që ajo do të zbatojë në vijim. Në këtë kontekst, Komisioneri mbështetet me mirëbesim në premtimin e kryetarit të Bashkisë Pogradec, të cituar shprehimisht edhe në shkresën nr. 1199/1, datë 24.03.2021, e këtij institucioni drejtuar KMD-së, ku theksohet fakti se këto familje do të trajtohen me prioritet, në lidhje me sistemimin e tyre me apartamente, mbështetur në programet e strehimit që zbaton kjo bashki, për familjet e pastreha.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesit nuk i janë ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Pogradec.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nuk mund të ketë diskriminim për shkakun e pretenduar në ankesë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

- 1. Mospranimin e ankesës së znj. M. R., pasi është haptazi e pabazuar.**

2. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. A. V., znj. G. E., znj. F. Rr. dhe znj. E. K., për shkak të racës, nga ana e Bashkisë Pogradec.
3. Rekomandohet që Bashkia Pogradec të marrë masa të menjëherëshme për trajtimin me prioritet të familjeve të z. A. V., znj. G. E., znj. F. R. dhe znj. E. K., në lidhje me sistemimin e tyre me apartamente, mbështetur në programet e strehimit, që kjo bashki zbaton për familjet e pastreha.
4. Në referencë të pikës 3 të këtij vendimi, Bashkia Pogradec të njoftojë Komisionerin në lidhje me masat që do të marrë në vijim për sistemimin e familjeve të sipërcituara.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira dhe Shërbime
Shkak – raca
Lloji vendimit - mosdiskriminim